



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 4191 Prot.
13

Tiranë më, 22/11/2022

VENDIM

Nr. 20, datë 22.11.2022

“Për miratimin e hapjes së programit të studimit Master i Shkencave në “Antropologji kulturore” nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Në mbështetje të nenit 49, nenit 71 “Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, nenit 75 “Programet e ciklit të dytë të studimeve”, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 1, datë 14. 04. 2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar, VKM nr. 41, datë 24. 01. 2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e ASA-së, Rregulloren e Bordit të Administrimit, si dhe Vendimit Nr. 14, datë 22.11.2022 të Senatit Akademik të ASA-së për miratimin e programeve të studimit, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit për hapjen e programit, në ciklin e dytë të studimit Master i Shkencave në “Antropologji kulturore”.
2. Efektet financiare për zhvillimin e programeve mbulohen nga buxheti i ASA-së dhe të ardhurat dytësore të institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

EMIS ÇERAVA

